

Kohëzgjatja:

I Tetor 2021 - 30 Janar 2024

Objektivi i Përgjithshëm

“Pikë Grumbullimi! Një alternativë e qëndrueshme zhvillimi për të rinjtë dhe komunitetet në Librazhd” do të zbatohet përgjatë 28 muajve në zonën e Librazhdit.

Komuniteti i Librazhdit është aktiv në eliminimin dhe parandalimin e kultivimit të drogave të paligjshme nëpërmjet masave të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik rural që përmirësojnë cilësinë e përgjithshme të jetës dhe sigurinë e qytetarëve.



Pikë Grumbullimi!
Një alternativë e qëndrueshme zhvillimi
për të rinjtë dhe komunitetet në Librazhd



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian
dhe zbatohet nga Bashkia Librazhd
në bashkëpunim me World Vision.



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian



Pikë Grumbullimi!

Një alternativë e qëndrueshme zhvillimi
për të rinjtë dhe komunitetet në Librazhd.



Qëllimi i projektit

Projekti synon ndërtimin dhe vënien në funksion të një Pike Grumbullimi (Food Hub), çertifikimin, marketimin dhe shitjen e produkteve në bashkinë Librazhd.

Kjo i jep zgjidhje sfidës për gjetjen e tregjeve si një hallkë e zinxhirit të vlerës ku fermerët për shkak të largësisë nga qendrat urbane hasin vështirësi dhe nuk kane nxitje të prodhojnë më shumë. Projekti do të ofrojë mundësi për fermeret dhe të rinjtë në zonë dhe do ti shtyje ata jo vetëm për të rritur prodhimet e tyre, por edhe për të përfituar nga modelet pozitive të njëri-tjetrit.



Përfituesit:

Përfituesit e projektit:

44.000 banorët
e bashkisë Librazhd.

Përfitues të drejtpërdrejtë:



360 fermerë

nga 6 linja prodhimi:
bletari, pemëtari/arrore, vreshtari,
patate, bulmetrat dhe bimët mjekësore.



1500 të rinj

nga mosha 12 deri në 18 vjeç



15 të rinj

nga mosha 18 deri në 25 vjeç



25 staf

të bashkisë Librazhd



5 OJQ

lokale

REZULTATET:

Ndërtimi i një Pike Grumbullimi përbri rrugës nacionale Elbasan – Librazhd e cila do të pajiset me asetet e duhura fizike dhe teknologjike.



Hartimi i një plani 5 vjeçar biznesi për piken e grumbullimit dhe angazhimin dy palësh të bashkisë Librazhd dhe World Vision.



Krijimi i një rrjeti të qëndrueshëm midis strukturave lokale për të identifikuar dhe lidhur fermerët me Pikën e Grumbullimit si dhe për t'i mbështetur ata gjatë me asistencë teknike, këshillim, nxitje, motivim për të investuar në zonë.



Certifikimi hap pas hapi i të gjitha produkteve në Pikën e Grumbullimit dhe pajisja e tyre me logon e Food Hub e cila do të garantojë cilësinë dhe sigurinë në treg. Si hap i parë, gjatë implementimit të projektit do të fillojmë me certifikimin e një produkti dhe brandimin e dy produkteve të tjera, si produkte ekskluzive, lokale të zonës së Librazhdit.



Të rinjtë pajisen me njohuri, aftësi dhe motivim për të patur një qëndrim pozitiv për vetëpunësimin dhe mbështeten të fillojnë aktivitete për gjenerim të ardhurash. Të rinj 12 deri në 18 vjeç, do të përfshihen në aktivitete ndërgjegjësimi për të dalluar më mirë riskun që sjell përfshirja në aktivitete të paligjshme si prodhimi, përdorimi, tregëtimi i substancave.

